



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr. 1, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 20/12/2018

V E N D I M

Nr.219, Datë 20/12/2018

**PËR
AUDITIMIN TEMATIK TË USHTRUAR NË
MINISTRINË E TURIZMIT DHE MJEDISIT "MBI REFLEKTIMIN NË
KONTABILITET DHE PASQYRA FINANCIARE TË AKTIVITETIT TË
PROGRAMEVE BUXHETORE TË CILAT NË ZBATIM TË VKM-VE PËRKATËSE
KALUAN NË PËRGJEGJËSINË SHTETËRORE, TË MINISTRISË SË TURIZMIT
DHE MJEDISIT
për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2017.**

Nga auditimi Tematik ÷ Mbi reflektimin në kontabilitet dhe pasqyra financiare të aktivitetit të programeve buxhetore të cilat në zbatim të VKM-ve përkatëse kaluan në përgjegjësinë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit konstatohet se, në Pasqyrat Financiare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, është reflektuar një pjesë e aktivitetit të ish-Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes, i cili gjatë vitit 2017, në zbatim të VKM-së nr. 509, datë 13.09.2017, kaloi në përgjegjësinë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit të Metodologjisë, Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të Ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 ÷ Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit,

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të auditimit Tematik ÷ Mbi reflektimin në kontabilitet dhe pasqyra financiare të aktivitetit të programeve buxhetore të cilat në zbatim të VKM-ve përkatëse kaluan në përgjegjësinë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, sipas programit të auditimit nr. 1037/1, datë 17.09.2018, për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2017.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i **pasqyrave financiare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit** rezultoi se, ky institucion ka përthithur një pjesë të aktivitetit të ish-MZHETTS. Programe e përthithura kanë financuar dy njësi varësie të ish-MZHETT, të cilat me ndryshimin e fushave të përgjegjësisë kaluan në varësi të MTM. Konsolidimi si pasojë e përthithjes është reflektuar edhe në pasqyrat financiare të konsoliduara, të cilat i kanë reflektuar ndryshimet për përthithjen e këtyre dy njësive. Nga auditimi u konstatua se, në Pasqyrat Financiare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për vitin 2017, është reflektuar pakësimi i aktiveve në vlerën **2,141,404 mijë lekë** për dy projekte investimi me Kapital të Brendshëm, të cilat referuar Aktit Normativ nr. 03, datë 06.11.2017, kaluan në administrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Dokumentacioni i transferimit të këtyre aktiveve pa pagesë nuk është në përputhje me procedurat e përcaktuara në udhëzimin 30, datë 27.12.2011 oPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publiko.

a. Në lidhje me projektin e investimit oNdërtimi dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Elbasan, për prodhimin e energjisëo përgjatë periudhës 10 muajore Janar-Tetor 2017, nga ish Ministria e Mjedisit janë kryer pagesa në vlerën 505,262 mijë lekë, ndërkohë që ky projekt me Akti Normativ nr. 3, datë 06.11.2017, kaloi në administrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Konstatohet se, për periudhën Dhjetor 2017, në lidhje me këtë projekt nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë janë kryer pagesa në vlerën 131,309 mijë lekë.

b. Në lidhje me projektin e investimit oDhënie me koncesion e ndërtimit e administrimit të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhim energjieo konstatohet se, përgjatë periudhës 10 muajore Janar-Tetor 2017, nga ish Ministria e Mjedisit janë kryer pagesa në vlerën 590,000 mijë lekë, ndërkohë që ky projekt me Akti Normativ nr.3, datë 06.11.2017, kaloi në administrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Konstatohet se, për periudhën Dhjetor 2017, në lidhje me këtë projekt nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë janë kryer pagesa në vlerën 162,770 mijë lekë.

Referuar sa më lart, konstatohet se, financimi i këtyre dy projekteve koncensionare është kryer nga programi 5320 oPrograme për mbrojtjen e mjedisit o i ish Ministrisë së Mjedisit për 10 muajt e parë të vitit, në vlerën totale 1,095,262 mijë lekë dhe për 2 muajt e tjerë të vitit financimi i këtyre dy projekteve është kryer nga programi 6220 oMenaxhimi i mbetjeve urbane" të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në vlerën 294,079 mijë lekë.

Pra Akti Normativ nr. 3, datë 06.11.2017 bëri të mundur copëtimin e investimit të vitit dhe investimit total të mbartur në vite duke kaluar investimet nga njëra ministri në tjetrën, megjithëse Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë **nuk rezultojnë të jenë të përfshira në konsolidime ndërmjet njëra tjetrës** (programi 5320oPrograme për mbrojtjen e mjedisit o i Ministrisë së Mjedisit, nuk ka kaluar në MIE, por në MIE kanë kaluar vetëm projektet e investimit të lartpërmendur pjesë e këtij programi). Pasqyrat Financiare të Aparatit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit vlera e këtyre aktive është pakësuar për 2,141,404 mijë lekë referuar pagesave të bëra në lidhje me këto investime, ndërkohë që kjo shtesë aktivesh **nuk është pasqyruar** në Pasqyrat Financiare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Referuar sa më lart nga ana e MTM, në lidhje me këto dy objekte, nuk janë ndjekur edhe procedurat e përcaktuara në udhëzimin 30, datë 27.12.2011 oPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publiko, i cili shprehet si më poshtë: *Për hyrjet e mallrave që qarkullojnë pa pagesë në njësitë e sektorit publik fletëhyrja e plotësuar nga përfaqësuesit e njësisë shpenzuese që ka bërë dalje mallin; shkresën e njësisë për transferimin e aktiveve; autorizimin për tërheqje malli të firmosur nga nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues. Për të gjitha hyrjet që bëhen pa pagesë, njësia publike pritëse e aktivitetit i përcjell akt-konfirmimin dërguesit brenda datës 20 të muajit pasardhës. Akt konfirmimi firmoset nga nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues i njësisë pritëse.*

1.1 Rekomandimi: Strukturat Drejtuese të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Strukturat Përgjegjëse të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë,

- a) të marrë masat e nevojshme në lidhje me plotësimin e dokumentacionit të plotë të transferimit të aktiveve pa pagesë referuar legjislacionit në fuqi, për dy projektet e investimit òNdërtimi dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Elbasan, për prodhimin e energjisë dhe òDhënie me koncesion e ndërtimit e administrimit të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhim energjie.
- b) të marrin masa për rakordimin e vlerave ndërmjet dy ministrive në lidhje me pagesat e kryera nga Ministria e Turizmit për këto projekte investimi.

Brenda vitit 2018

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi reflektimin në buxhetin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM) të programeve buxhetore, të cilat në zbatim të VKM-^{ve} përkatëse kaluan në përgjegjësinë shtetërore të saj, si dhe rakordimi i planit të buxhetit me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në mbyllje të periudhës ushtrimore të vitit 2017, rezultoi:

a. Diferenca e planit me ndryshime për gjithë programet e grupit 26 me aktin normativ nr.3, në krahasim me planin me ndryshime me aktin normativ nr. 2, rezultoi për - 894,000 mijë lekë, ndërsa shuma e shkresave të alokimit të këtij akti normativ është në vlerë - 56,082 mijë lekë, me një diferencë prej **-837,918 mijë lekë**, diferencë e cila duhet të jetë e barabartë me alokimet nga përdorimi i fondeve me VKM të Fond Rezervë të Buxhetit të Shtetit dhe Fondeve të Kontigjencës. Por institucioni nuk na e vërtetoi këtë diferencë me VKM dhe shkresat për përdorimin e fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit dhe Fondeve të Kontigjencave, apo ndryshime të tjera sidomos në programin 05320 òPrograme për mbrojtjen e mjedisit, program i cili ka diferencë të mëdha midis dy akteve normative dhe midis aktit normativ nr.3 dhe planit me ndryshime të raportuar në raportet e monitorimit. Pra nga programi 06220 òMenaxhimi i mbetjeve urbane ò i janë alokuar dy projekte investimi Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si:

- òInceneratori Elbasanit ò që i ka kaluar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në muajin dhjetor 2017, në vlerë 1,425,944 mijë lekë dhe nga fondet e vitit 2017 është alokuar vlera prej 505,262 mijë lekë;

- òImpjanti i prodhimit të energjisë nga mbetjet në Fier, në vlerë 715,461 mijë lekë është alokuar vlera prej 590,000 mijë lekë nga fondet e vitit 2017.

b. Të dhënat dhe tabelat plotësuese të Raportit të Monitorimit për vitin 2017, janë dorëzuar në MFE, por plotësimi i Raportit të Monitorimit nuk është bërë duke reflektuar për programin e përthithur, me vlerat e aktin normativ nr.3, por si në plan dhe në fakt janë plotësuar vetëm për shumat e planifikuara dhe realizuara të muajit dhjetor 2017.

2.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të MTM/Strukturat që merren me programimin dhe Monitorimin e Buxhetit, të argumentojnë ndryshimet në buxhetin e vitit 2017, në mënyrë që plani me ndryshime të jetë i barabartë me Aktin e fundit normativ të zbatimit të Buxhetit dhe VKM-^{të} e përdorimit të Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit, apo Fondit të Kontigjencave, me qëllim që Raportet e Monitorimit të Buxhetit të pasqyrojnë drejt programimin, domosdoshmërinë dhe ligjshmërinë e ndryshimeve të tij gatë vitit buxhetor, si dhe saktësinë e realizimit të buxhetit me programe e produkte.

Brenda vitit 2018

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi miratimin e strukturës së re organike dhe marrjes në ngarkim të detyrave pas procesit të përthithjes së veprimtarisë të programeve buxhetore, rezultoi:

a. Në lidhje me **dorëzimin e detyrës** u konstatua se, nga punonjësit e larguar nga pozicioni si rezultat i ristrukturimit të Ministrisë nuk është bërë dorëzimi i punës dhe marrja në dorëzim e punës. Mosdorëzimi i detyrës ka sjell përdorim pa efektivitet të fondeve publike, nisur nga fakti se punonjësit kanë marr pagë edhe në kushtet kur nuk kanë mbaruar detyrat e tyre përkatëse në kohë dhe as kanë bërë dorëzim detyre. Grupi auditimit konstatoi se: Asnjë prej 16 punonjësve të MZHETTS, përthithur nga MTM dhe struktura varësie **nuk ka bërë dorëzim detyre**, ndërkohë që grupi i auditimit konstatoi se MTM ka paguar për muajin dhjetor punonjësit e MZHETTS duke sjell përdorim pa efektivitet të fondeve publike.

b. Në lidhje me **komisionin e ristrukturimit** u konstatua se, ka vepruar në kundërshtim me aktet rregullatore për sa i përket vonesave të konstatuara në procedurën e ristrukturimit të Institucioneve gjatë transferimit të punonjësve. Komisioni brenda 15 ditëve nga momenti i krijimit duhet të propozonte DAP transferimin e nëpunësve në një nga pozicionet e lira sipas procedurës ndërkohë që propozimi është bërë në datat 15 nëntor, 17 nëntor, 22 nëntor, 24 nëntor dhe 19 dhjetor, pra jashtë afateve të përcaktuara në VKM Nr. 125 Datë 17.02.2016, pika 17. Nga auditimi pas procesit të ristrukturimit në lidhje me pozicionet e punës konstatohet ulje në kategori.

c. Në lidhje me **Vendimet Gjyqësore**, ky institucion nuk ka përthithur asnjë prej vendimeve gjyqësore të strukturave të përthithura nga ish-MZHETTS. Si rezultat nuk mund të shprehemi për detyrimet e mundshme si pasojë e mosvënies në dispozicion të kësaj evidence auditimi duke evidentuar një risk të lartë në vlerësimin e detyrimeve ligjore si Institucion përgjegjës për mbartjen dhe reflektimin e tyre në bilancin vjetor të njësisë. Grupit të auditimit iu vu në dispozicion vetëm lista e vendimeve gjyqësore me objekt rikthimin në punë për të larguarit nga puna të Ministrisë Mjedisit.

3.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të MTM/Nëpunësi Autorizues dhe Strukturat që merren me Burimet Njerëzore të bëjnë të mundur:

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si njësi përthithëse e ish MZHETTS, duhet të bashkërendojë punën me të gjithë drejtoritë përkatëse për realizimin e procesit të dorëzimit dhe marrjes së detyrës, sipas standardeve të përcaktuara me ligj.

Përfundimin e përthithjes së vendimeve gjyqësore të ish-MZHETTS në mënyrë që të shmangen impaktet e padëshiruara në lidhje me krijimin e detyrimeve të prapambetura si pasojë e mosparaqitjes në kohë të vendimeve për shlyerje.

Brenda vitit 2018

B. Çështje të tjera:

a. Pasqyrat financiare të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të periudhës 01.01.2017 deri në 31.12.2017 janë audituar nga KLSH sipas programit të auditimit nr. 1084/1, dt. 17.09.2018.

Lloji i opinionit të shprehur nga audituesit është *òopinion i pakualifikuar*.ò sipas vendimit të Kryetarit të KLSH-së nr. 202, dt. 17.12.2018 dërguar MTM me shkresën nr. 1084/5, dt. 17.12.2018.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R